

**Njoftim i përqendrimit ndërmjet A1 TELEKOM AUSTRIA AG dhe NTT Austria GmbH, Austri**  
**(lënda nr. 08-81/2024)**

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 30.04.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin A1 TELEKOM AUSTRIA AG, një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Austrisë, me numër regjistrimi FN 280571f, me seli në Lasalleshtrese 9, 1020, Vjenë, Austri do të fitojë kontrollin mbi NTT Austria GmbH me seli të regjistruar në Austri Kampus 3, Jakov-Lind-Shtrase 5/4.OG, 1020 Vjenë, Austri.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

Aktivitetet e biznesit të A1 TELEKOM AUSTRIA AG përbëhen nga shërbimet bazë të telekomunikacionit, aksesit në internet, televizioni kabllor digjital, teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), shërbimet e shitjes me shumicë, si dhe zgjidhjet për aktivitetet e biznesit në lëvizje dhe zgjidhjet e pagesave.

A1 TELEKOM AUSTRIA AG është pjesë e Grupit A1 Telekom Austria, dhe është në pronësi të drejtpërdrejtë të Telekom Austria AG, , Austria, (“Telekom Austria”<sup>1</sup>). Telekom Austria AG është një kompani holding që nuk ofron asnjë shërbim. Portofoli i biznesit të Grupit A1 Telekom Austria përbëhet nga aktivitete në fushën e telefonisë zanore, aksesit në internet me brez të gjerë, shërbimeve multimediale, të dhënave dhe zgjidhjeve IT.

Grupi A1 Telekom Austria është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes

- A1 MAQEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli në Ploshtad Presveta Bogorodica nr. 1, Qendra Shkup –, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në telekomunikacionet pa tel;
- TELEMEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Ploshtad Presveta Bogorodica nr. 1, Shkup – Qendra, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në shpërndarjen e filmave, videove dhe programeve televizive;
- Linvorks SHPKNJP Shkup me NUAS 7556381, me seli në Ploshtad Presveta Bogorodica nr. 1, Qendra Shkup –, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në programimin kompjuterik.

**NTT Austria GmbH** është një ofrues i harduerit dhe softuerit të IT-së dhe fokusohet në integrimin e sistemit dhe shërbimet e menaxhuara. NTT Austria GmbH ofron shërbime të personalizuar dhe siguron praktikat më të mira të qëndrueshme në dizajn dhe operacione në qendrat e saj të të dhënave të sigurta, shkallëzuese dhe adaptuese. Megjithatë, këto

---

<sup>1</sup> Kontrolli i vetëm mbi Telekom Austria AG kryhet nga kompania Amerika Movil SAB de CV.. Amerika Movil është aktive në Amerikën Veriore, Qendrore dhe Jugore,. Oferta e produkteve të Amerika Movil Group përfshin shërbime të telefonisë celulare dhe fikse, akses me brez të gjerë, si dhe televizion.

aktivitete janë të kufizuara në territorin e Austrisë dhe NTT Austria GmbH nuk ka asnjë aktivitet në territorin e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesit e njoftimit konsiderojnë se tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si:

- Tregu për shpërndarjen e produkteve të TI-së, me fokus në produktet e sigurisë kibernetike për ndërmarrjet dhe shërbimet dhe shërbimet kufitare në vendosjen, mirëmbajtjen dhe aplikimin e produkteve të tilla të TI-së.
- Tregu për sistemet PBX (Private Branch Exchange) që përfshijnë zgjidhje telefonike për përdorim brenda një kompanie për komunikim të brendshëm në një rrjet privat. Ato bazohen në një kombinim të harduerit dhe një zgjidhje softueri ose softueri të integruar.

Tregu relevant gjeografik duhet të përkufizohet si territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

07.05. 2024

Shkup